



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0616

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen; Isa Hasani-Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE MBB Construction SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 02.09.2024, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet si e palejuar ankesa e datës 10.07.2024, me nr. 2024/0616 e Operatorit Ekonomik (OE) "MBB Construction" SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse” me numër të prokurimit; 616-23-12502-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 26.06.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58) e Autoritetit Kontraktues, ku ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik N.N.P. EURO CONSTRUCTION ;SINANI - ING SH.P.K.; TIC LOG SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë me vlerë të parashikuar të kontratës 350,000.00 euro.

Me,28.06.2024 Operatori ekonomik OE- MBB,Construction,SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 03.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE MBB Construction SH.P.K., me numër protokollit 2024/0616 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues MBB Construction SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Vlerësimi i Ankesës së OE “MBB Construction” Sh.P.K. dhe “Protec” Sh.P.K. përfshin një shqyrtim të detajuar të dëshmimeve dhe procedurave të prokurimit në lidhje me aktivitetin e prokurimit të titulluar “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse”, nr. prokurimi 616-23-12502-5-2-1. Aktiviteti është një procedurë e hapur për punë me vlerë të mesme, dhe pas rivlerësimit më 04.01.2024, janë kërkuar sqarime shtesë për pajisjet e ofruara, të cilat janë dorëzuar dhe në sistemin e prokurimit dhe fizikisht në zyrën e prokurimit.

OE “MBB Construction” Sh.P.K. dhe “Protec” Sh.P.K. kanë paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat për ofrimin e kamionit me kran dhe kiper me peshë bartëse minimale prej 2 ton. Dëshmitë përfshijnë sqarime rreth kamionit, marrëveshjet midis Arhing Group Shpk dhe Ardian Sylja, si dhe midis MBB Construction Sh.P.K. dhe Ardian Sylja, fotografi dhe librezë e kamionit.

Megjithatë, OE “MBB Construction” Sh.P.K. dhe “Protec” Sh.P.K. argumentojnë se komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje në disa aspekte. Së pari, G i OE “N.N.P Euro Construction” & “Sinani –Ing” & “Tic Log” Sh.P.K. nuk kanë paraqitur certifikatat për ISO të kërkuara për çdo anëtar të grupit. Së dyti, katalogu dhe specifikimet teknike të paraqitura nga ky grup nuk janë të autorizuar dhe deklaratat e tyre sugjerojnë përdorimin e produkteve nga prodhues të ndryshëm, në kundërshtim me kërkesat e tenderit. Së treti, lista e kontratave të realizuara nga OE “Sinani –Ing” nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës. Së katërti, dëshmitë për përvojën e kërkuar të inxhinierit janë të paplota dhe sigurimi i tenderit është skaduar dhe nuk është vazhduar.

OE “MBB Construction” Sh.P.K. dhe “Protec” Sh.P.K. kërkojnë që OSHP-ja të shqyrtojë tendencat diskriminuese dhe të marrë vendim për anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58). Ata kërkojnë gjithashtu që AK-ja të respektojë dispozitat e LPP-së dhe të ndalet prolongimi i procesit të prokurimit.

Në bazë të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura, OE “MBB Construction” Sh.P.K. dhe “Protec” Sh.P.K. kërkojnë që ankesa e tyre të miratohet, duke u marrë parasysh të gjitha shkeljet dhe mosplotësimet e kërkesave të përmendura. Për këtë arsye, OSHP-ja duhet të kërkojë që lënda të kthehet në rivlerësim, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në LPP për të siguruar që kërkesat dhe dokumentet

të trajtohen në përputhje me rregullat e prokurimit.

Duke u referuar kërkesave si më sipër MBB Construction SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenet 1, 6, 52, 57, 59, 60, 64, 67, 69, 70 dhe 108/A paragrafi 12 të LPP-së po ashtu MBB Construction SH.P.K., konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me Nenet 4 paragrafi 4.1 dhe 4.2, 24 paragrafi 24.4, 26 paragrafi 26.1 dhe 26.2, 28 paragrafi 28.1, 29 paragrafi 29.1, 31 paragrafi 31.2, 31.4, 31.5 dhe 31.6, 41 paragrafi 41.3, 41.5 dhe 41.12 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Operatori ekonomik "MBB Construction" Sh.P.K., i njohur si parashtrues, ka paraqitur një kërkesë për rishqyrtim më 28.06.2024 kundër vendimit të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit për ndërtimin e objektit të Arkivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse, me numrin e prokurimit 616-23-12502-5-2-1. Pas shqyrtimit paraprak, kërkesa është konsideruar e lejuar dhe e paraqitur në kohë nga personi i autorizuar, duke përmbushur kushtet për shqyrtimin meritore të saj.

Pretendimet e parashtruesit janë se arsyet për eliminimin e tij janë të pabazuara dhe se oferta e tenderuesit të rekomanduar është e papërgjegjshme, pasi nuk ka përmbushur kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional. Sipas letrës standarde për tenderuesit e eliminuar, parashtruesi është shpallur i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen kamion me kran dhe kiper me peshë bartëse minimale 2 ton, siç kërkohej nga dosja e tenderit dhe specifikimet teknike. Ky fakt është konfirmuar edhe nga vendimi i Organit Shqyrtues për Prokurim Publik me shenjë OSHP:2024/0104 të datës 30.05.2024.

Lidhur me pretendimet kundër tenderuesit të rekomanduar, parashtruesi nuk mund të dëshmojë interes material nga rezultatet e aktivitetit të prokurimit pasi vetë ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme. Sipas nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), për të qenë palë e interesuar, një person duhet të dëshmojë se ka interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Parashtruesi, duke qenë se është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për shkak të ofertës së tij të papërgjegjshme, nuk është konsideruar palë e interesuar. Megjithatë, oferta e tenderuesit të rekomanduar është e vetmja e përgjegjshme dhe me çmimin më të lirë, duke u përputhur me kriteret e dhënies së kontratës.

Në përfundim, parashtruesi nuk ka ofruar argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij, dhe kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0616, ndërsa me datë 18.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0616 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankesës të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe Rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk përgjigjur lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Lidhur me pretendimet e OE MBB Construction SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0616 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, zhvilloi një procedurë prokurimi për ndërtimin e objektit të Arkivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse, me numrin e prokurimit 616-23-12502-5-2-1. Njoftimi për këtë kontratë u publikua më 09.11.2023, dhe hapja e ofertave u realizua më 04.12.2023.

Më 26.06.2024, OE "MBB Construction" Sh.P.K. paraqiti një kërkesë për ri-shqyrtim të procesit, e cila u refuzua më 02.07.2024. Pas këtij refuzimi, OE "MBB Construction" Sh.P.K. paraqiti një ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik më 10.07.2024. Eksperti Shqyrtues shqyrtoi pretendimet e OE-së dhe i vlerësoi në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë dëshmitë e ofruara si librezat dhe marrëveshjet për shfrytëzim. Sipas Rregullores për Prokurim Publik nr. 001-2022, çertifikatat për ISO duhet të vërtetohen në përputhshmëri me standardet e caktuara, dhe AK-ja ka vepruar në kundërshtim me këtë kërkesë. Pretendimi lidhur me vlerën e kontratave u hodh poshtë pasi vlera totale e kontratave ishte 500,000 €, dhe 60% e kësaj vlere është kërkuar të përmbushet nga bartësi i konsorciumit, që është më shumë se 60% e vlerës totale. Kërkesa për përvijën e punës të Inxhinieres Qëndresë Xhevat Tërpkollit u pranua, duke e pranuar se përvija duhet të dëshmohet nga pas diplomimit, ndërsa AK-ja ka vepruar në mënyrë të kundërshtueshme në këtë rast. Për pretendimin lidhur me sigurimin e tenderit, OE-së iu hodh poshtë ankesa pasi në platformën e-prokurimi është evidentuar vazhdimi i validitetit të sigurimit. Në përfundim, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje ligjore në dy raste lidhur me përgjegjshmërinë dhe mospërgjegjshmërinë e operatorëve ekonomikë, duke krijuar një pasiguri juridike dhe duke rezultuar në një vlerësim dhe krahasim të ofertave që ishte kryesisht formal dhe jo profesional. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankesues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe Rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të Anulohet në tërësi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me

dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1, duke e zbatuar vendimin e OSHP-së me numër;104/2024, lidhur me ket aktivitet te prokurimit. Paneli shqyrtues vren se autoriteti kontraktues, Komuna e Prishtinës ne zbatim të vendimit të Panelit shqyrtues me numër 2024/104, të datës, 30/05/2024, në procesin e rivlerësimit ka rekomanduar për kontrate OE i cili sipas vlerësimit të Komisionit vlerësuar ka plotësuar kërkesat e Dosjes se tenderti.

Paneli shqyrtues lidhur me ket aktivitet te prokurimit “Ndërtimi i objektit të Arhivës së Komunës me infrastrukturë përcjellëse” me numër të prokurimit 616-23-12502-5-2-1, të Komunes së Prishtinës vëren , se kjo lëndë është vendosur nga ana e Organit te Shqyrtimit Publik më herët, me vendimin 2024/0104, të datës, 30/05/2024, ku OE- MBB Construction SH.P.K. ishte i rekomanduar per kontrate nga autoriteti kontraktues, tani ankues. Me vendimin 2024/104 paneli shqyrtues ka konstatuar se Operatori ekonomik i rekomanduar per kontratë, OE-MBB Construction SH.P.K, është i papërgjegjshëm, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e Dosjes së tenderit andaj dhe lënda është kthyer ne Rivlersim. Në vendimin me numër; 2024/0104 Paneli shqyrtues ka konstatuar si ne vijim *"Paneli shqyrtues lidhur me pretendimit e Ankuesit për mos plotësim të pikës 7 nga OE i rekomanduar vlerëson se në dokumentacionin e paraqitur në ofertën e OE së rekomanduar mungojnë dëshmitë se OE posedon pajisjen "Kamion me kran dhe kiper dhe peshë bartëse minimum 2 ton" siç është kërkuar në pikën 1 të Aneksit 7, andaj Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka rekomanduar OE dhe shpallur fitues pa i plotsuar kerkesat e DT, dhe dispozitave ligjore të LPP-së."*

Andaj Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe vendimin e Panelit shqyrtues me numer:2024/104, të datës, 30/05/2024,ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik MBB Construction SH.P.K të hidhet poshtë si e palejuar, pasi që i njëjti nuk ka arritur të dëshmojë se ka interes juridik material ashtu siç parashihet në nenin 4 par 1.26 i LPP për statusin “Palë e interesuar”, sipas së cilës dispozitë, vetëm pala që arrinë të dëshmojë se ka interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në një kontratë publike nga i cili aktivitet publik ka rrezik ti shkaktohet ndonjë shkelje mund të jetë palë e interesuar në atë procedurë.

Paneli shqyrtues, përfundimisht nga të cekurat si më lartë, e hedhe poshte ankesen si të palejuar të operatori ekonomik, OE-MBB Construction SH.P.K nr. 2024/0616, sepse ankesa për këtë procedurë të prokurimit, konsiderohet çështje e gjykuar sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: *“Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, dhe konfrom nenit 4, 1. 26 të ligjit, të LPP-së, Paneli shqyrtues ka nxjerr vendimin me numër;2024/104,të datës, 30/05/2024,per çështjen e njejtë ankimore, andaj dhe kjo ankese konstatohet si lëndë e vendosur nga OSHP.*

Paneli sqaron se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, zotim ky i shprehur përmes Formularit për Dorëzim të Tenderit dhe që i bashkangjitet ofertës së secilit OE ofertues. OE kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë. Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre.

Po ashtu, për ankuesit bie edhe barra e provës që të ofrojnë të gjitha faktet në momentin e kërkesës për ri-shqyrtim dhe ankesës në OSHP, me qëllim që të vërtetojnë se të njëjtit janë të

përgjegjshëm me qëllim që të mund të aplikohen nëse është e nevojshme dhe e mundshme edhe dispozitat ligjore për sqarim, dispozita këto të cilat nuk detyruese.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin, 59.4 dhe 59.1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës".

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit në Gjykatën Komerciale/Departamenti për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - MBB Construction SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: